Gjëndjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarëve fizikë të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë konvertuar në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të Bankës së Shqipërisë.

4.2 Inventari

Inventari përbëhet nga mallra të ndryshme industriale si materiale elektrike, hidraulike, pajisje ndricimi, pajisje hidrosanitare, mobilje, kopshtari etj. për vlerën 1,331,468,888 lekë. Gjëndjet e inventarit në fillim dhe në fund të ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Inventari		
Mallra per rishitje	1,331,468,888	1,171,391,846
Shuma	1,331,468,888	1,171,391,846

Vlerat e inventarit të paraqitura më sipër, përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në fund të ushtrimit 2017. Drejtimi mendon se vlera e paraqitur është vlera më e ulët mes koston së marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevoja për zhvlerësime të tij.

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

4.3 Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kërkesat e arkëtueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2017 përbëhen nga klientë në shumën 117,179,652 lekë.
 Kërkesa të tjera të arkëtueshme, përbëhet nga tatimin fitimi i parapaguar për shumën 2,407,368 lekë objekt Apelimi pranë Gjykatës së Apelit, dhe 5,856,458 lekë gjendje kreditore për tatim fitimin e periudhës kontabël 2017, depositë garancie ligjore për çështjen gjyqësore pranë DPD për shumën 12,569,647 lekë, depositë garancie ligjore për çështjen gjyqësore pranë DPT për shumën 7,000,000 lekë, garanci doganore në shumën 10,000,000 lekë për autorizimin e magazinës doganore C-42, gjendje kreditore të llogarisë operationale me Degët Doganore në shumë 8,748,895 lekë, garanci për aplikim për tender në shumën 16,478,466 lekë si dhe likuiditete të tjera të arkëtueshme.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme (Kliente)	117,179,652	126,939,587
(ii) Kërkesa të tjera të arkëtueshme	63,336,493	54,105,708
(iii) Instrumente të tjera borxhi		
(iv) Investime të tjera financiare		
Shuma	180,516,146	181,045,295

4.4 Kërkesa të Arkëtueshme-Klientë

Shoqëria nuk ka përqëndrim të rëndësishëm të riskut të kreditimit, me një zbulim të shpërndarë në një numër të madh të tretësh dhe klientësh. Në raport me kapitalin e shoqërisë, kemi një përqëndrim të ulët të rriskut të arkëtimit nga shitjet. Drejtimi nuk ka vlerësuar klient potencialë në pamundësi likuidimi.

4.5 Të tjera aktive afatshkurtëra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra, përbëhen nga 1,460,267 lekë parapagime, 638,289 janë parapagime të marra nga klient, 4,080,415 janë të drejta të arkëtueshme në pritje, 1,349,784 lekë janë shpenzime me kusht, dhe të drejta tregtare, ndërsa 1,337,051 lekë janë shpenzime të shtyra, pasi kanë lidhje me kontratën me afat të sigurimit të ndërtesës tregtare. Shpenzimet e shtyra janë amortizuar në bazë mujore.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Aktive biologjike afatshkurtra		
Aktive afatshkurtra të mbajtura për shitje		
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	7,589,227	6,497,968
Shuma	7,589,227	6,497,968

Shënimet shoqëruese 4.1 deri në 4.17 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
(Të gjitha balancat janë në lekë).

4.6 Aktive Afatgjata

Nr Llogarise	Emertimi i Llogarise	Debi	Kredi	Monedha
208	Programe Informatike	67,023,666		Leke
211	Toka	1,500,000,000		Leke
212	Ndertesa	2,556,833,528		Leke
213	Makineri, paisje, instalime teknike	50,284,652		Leke
215	Mjete Transporti	46,906,376		Leke
218	Mobilje dhe Paisje Zyre	187,364,882		Leke
218	Paisje Zyresh dhe Informatike	107,169,413		Leke
218	Aktive te tjera materiale	5,508,294		Leke
280	Per Programe Informatike		43,005,354	Leke
2810	Per mobilje dhe orendi		99,870,754	Leke
2811	Pajisje zyresh dhe informatike		68,577,042	Leke
2812	Per ndertesa		476,149,950	Leke
2813	Per makineri, paisje, instalime teknike		11,106,114	Leke
2815	Per mjete transporti		21,420,657	Leke
2818	Per te tjera AA materiale		8,684,389	Leke
	Totali	4,521,090,811	728,814,260	
	Diferenca	3,792,276,551		

Pasqyra e ndryshimeve në (AAM-të)

Gjendjet dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

	Gjendjet dhe lëvizjet	Toka	Ndertesa	Ndërtim në proces	Makineri dhe paisje	Mjete transporti	Aktivitet të tjera afatgjata materiale	Totali
A	Kosto e AAM-ve më 01.01.2017	1,500,000,000	2,407,709,714	0	30,384,298	39,999,317	350,381,014	4,328,474,343
	Shtesat		149,123,814		20,620,891	6,907,059	16,840,302	193,492,066
	Pakesimet				(720,537)		(155,061)	(875,598)
	Kosto e AAM-ve 31.12.2017	1,500,000,000	2,556,833,528	0	50,284,652	46,906,376	367,066,256	4,521,090,811
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2017		(362,135,792)	-	(25,716,631)	(16,740,272)	(163,355,019)	(567,947,714)
	Amortizimi ushtrimor		(114,014,158)		(4,638,931)	(4,680,385)	(38,022,983)	(161,356,457)
	Amortizimi për daljet e AAM-ve				389,666		100,245	489,911
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2017		(476,149,949)	-	(29,965,896)	(21,420,657)	(201,277,757)	(726,814,259)
C	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2017							-
	Shtesat							-
	Pakesimet							-
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2017							-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2017	1,500,000,000	2,045,573,922	0	4,667,667	23,259,045	187,025,995	3,760,526,629
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2017	1,500,000,000	2,080,683,579	0	20,318,756	25,485,719	165,788,498	3,792,276,551

Shënimet shoqëruese 4.1 deri në 4.17 janë pjesë përbërse e aktivit pasqyrave financiare

MEGATEK Sh.a
K816070500
Superstrada Tiranë - Durrës
+ 355 4 23 88 333
www.megateksa.com

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria ka kryer në fund të muajit dhjetor 2017. Si politikë kontabël për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SNK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë ushtrim kontabël, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë ato që përdoren për qëllime fiskale. (shih shenimin nr 3.g). Norma e llogaritur e amortizimit si shpenzim, nuk i tejkalon kufijtë e njohur nga Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat.

4.7 Kapitali aksionar i papaguar

Përfaqëson detyrmin e ortakut mbi Kapitalin Themeltar të papaguar për 200,000 lekë.

4.8 Detyrime afatshkurtëra-Huamarrjet

Huatë dhe parapagimet afatshkurtëra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2017 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Huamarrjet		
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra	1,282,527,683	1,310,312,168
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata		
(iii) Bono të konvertueshme		
Shuma	1,282,527,683	1,310,312,168

Shoqëria ka marrë një hua bankare overdraft nga Alpha Bankë dhe gjëndja e saj më 31.12.2017 është 4,991,087 Euro e konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2017 në shumën 663,565,563 Lekë.

Shoqëria ka marrë një hua bankare overdraft nga Tirana Bankë dhe gjëndja e saj më 31.12.2017 është 4,655,601 Euro e konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2017 në shumën 618,962,120 Lekë.

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

4.9 Detyrime afatshkurtëra-huatë dhe parapagimet

Huatë dhe parapagimet afatshkurtëra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2017 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Huate dhe parapagimet		
(i) Te pagueshme ndaj Furnitoreve	1,036,149,380	899,474,824
(ii)Te pagueshme ndaj Punonjesve	5,623,200	4,079,502
(iii)Detyrime tatimore	8,408,372	18,302,680
(iv)Huara te tjera	894,943,248	712,726,466
(v)Parapagimet e arketuara		
(vi)Shpenzime per t'u shperndare	440,241	11,861,517
Shuma	1,945,564,442	1,646,444,989

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve të pa likuaduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventarët kontabël dhe shuma e llogarisë sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për cdo furnitor. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitorëve janë të vlerësuara realisht. Të pagueshme ndaj punonjësve përfaqësojnë detyrimin për pagat në shumën 5,623,200 lekë.

Detyrimet tatimore, përfaqësojnë detyrimin për sigurimet shoqërore në shumën 1,778,437 lekë, tatimin mbi të ardhurat personale (TAP) në shumën 43,102 lekë, tatimi në burim në shumën 1,748 lekë, (TVSH) të pagueshme për muajin dhjetor 2017 në shumën 6,585,084 lekë.

Shuma prej 440,242 lekë përfaqëson interesat e maturuara sipas skemës së amortizimit të parashikuar në marrëdhënien kontraktuale me institucionet e bankave kredidhënëse.

Hua të tjera përbëhet kryesisht nga kreditimi nëpërmjet kompanive të grupit. Shoqëria, ka nënshkruar marrëdhënie kontraktuale të financimit pa interes. Financimi, nëpërmjet shoqërive të grupit ka rritur garancinë e likuiditetit dhe atë të operacioneve tregtare.

4.10 Detyrime ndaj Furnitorëve

Kryesisht detyrimi ndaj furnitorëve reflekton marrëdhënien me shoqëritë e grupit. Vlerësohet se shoqëria nuk ka një përqendrim të riskut të likuidimeve, ndaj furnitorëve jo të grupit, krahasuar kjo me nivelin e detyrimeve, nivelin e likuiditetit dhe atë solvabilitetit.



MEGATEK sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

4.11 Detyrime Afatgjata-Huatë afatgjata

Huatë afatgjatë në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël 2017 paraqiten si vijon:

Shoqëria ka marrë një hua bankare afatgjatë nga Alpha Bankë, dhe gjëndja e saj më 31.12.2017 është 3,470,228 Euro e konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2017 në shumën 461,366,836 Lekë.

Shoqëria ka marrë një hua bankare afatgjatë nga Tirana Bankë, dhe gjëndja e saj më 31.12.2017 është 3,470,227 Euro e konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2017 në shumën 461,366,732 Lekë.

Shoqëria ka marrë një hua bankare afatmesme nga Tirana Bankë në lekë dhe gjëndja e saj më 31.12.2017 është 56,362,956 Lekë.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016
DETYRIME AFATGJATA		
I-Huatë afatgjata		
(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	979,096,524	1,113,066,520
(ii) Bonot e konvertueshme		
Shuma (I)	979,096,524	1,113,066,520
2-Huamarrje te tjera afatgjata		
3-Provizione afatgjata		
4-Grantet dhe te ardhurat e shtyra		1,290,030
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA(1-4)	979,096,524	1,114,356,550

4.12 Kapitale të veta.

Gjatë ushtrimit kontabël 2017, nuk ka patur ndryshime në raportet e zotërimit të Aksioneve. Raporti i aksioneve përbëhet nga :

Shoqëria Megatek sh.a , ka një kapital të regjistruar në QKR për 1.519.000.000 lekë, i cili zotërohet nga ortakët :

- Z. Dionis Teqja me 99.99% të kuotave të Kapitalit
- Z. Apostolos Pefkos me 0.01% të kuotave të Kapitalit.



MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

Kapitali përbëhet si më poshtë:

	Ushtimi i Mbyllur	Ushtimi i Mbyllur
	31.12.2017	31.12.2016
Kapitali i nenshkruar	1,519,000,000	1,519,000,000
Rezerva Ligjore	90,804	90,804
Rezerva Staturore		
Rezerva te tjera	(473,989,634)	(473,989,634)
Fitimi i pashperndare	19,192,712	60,416,071
Fitimi i vitit korrent	91,654,990	(41,223,359)
Totali	1,155,948,872	1,064,293,882

4.13 Fitimi (humbja) e vitit financiar

Shpenzimet dhe të ardhurat sipas natyrës

Të ardhura e realizuara gjatë ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) të biznesit paraqitet në vijim. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Të ardhurat nga shërbimet e tjera janë njohur deri në masën e shpenzimeve të rikuperueshme, të njohura në kontabilitet. (Njohja dhe vlerësimi janë bazuar në SKK-8). Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre.

Midis të ardhurave nga shitjet me tvsh 20% të deklaruar në FDP dhe të ardhurave të paqyruara në PASH ka një diferencë në shumën 6,368,096 lekë. Kjo diferencë vjen prej faktit se në FDP është deklaruar shuma 6,368,096 lekë e cila i përket faturave të përpiluara duke zbatuar nenin 24 pika 4 të Udhëzimit Nr. 6 datë 31.01.2015 për TVSH, "për autofaturimin".

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Te ardhurat		
Te ardhurat nga shitja e produkteve (701)		
Te ardhurat nga shitja e punimeve dhe shërbimeve(704)		
Te ardhurat nga shitja e mallrave (705)	2,018,581,562	1,615,199,098
Te ardhurat nga shitja materialeve dhe furniturash(707)		
Te ardhura nga shitje te tjera (Qera,Komisione)(708)	69,911,399	23,896,061
Prodhim I AAM (722)		
Te ardhura nga grantet (730)	1,573,542	1,721,240
Te ardhurat te tjera korrente (750)	29,567	69,106
Te ardhura nga shitja AAM (752)	729,468	10,729,634
Te ardhura te tjera rrjedhese	4,251,840	
Shuma	2,095,077,377	1,651,615,139

MEGATEK sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë rregjistruar me shumën e paguara ose të pagueshme. Kostoja e punësimit, pagë dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime të tjera që lidhen me biznesin, janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit. Shpenzimet e tjera që në një masë të konsiderueshme përbëhen nga furnitura, nëntrajtme dhe shërbime nga të tretë paraqitet e analizuar sipas pasqyrës së paraqitur më poshtë.

	Ushtrimi i mbyllur me 31.12.2017	Ushtrimi i mbyllur me 31.12.2016
4-Materialet e konsumuara		
1-Lende të para (601-608)		
2-Produkte (Paksim i produkteve të veta)		
3-Mallra (601-608)		
4-Materiale ndërtimi të tjera		
Shuma	0	0
7-Shpenzime të tjera (61-66)		
1-Blerje/shpenzime të materiale të tjera (602)		
2-Blerje energji elektrike (604)		
3-Blerje karburant (604)	25,711,281	22,440,290
4-Blerje amballazhi për mallrat (606)	4,690,650	6,177,907
5-Blerje materiale kancelarie (607)		
6-Blerje produkte mence (607)		
7-Blerje/shpenzime të tjera (608)		
8-Zbritje financiare nga furnitori (609)	3,971,795	4,703,954
9-Zbritje financiare për klient (610)	11,362	(14,219)
10-Shërbime nga të tretët -nenkontraktor (611)	2,499,668	1,298,405
11-Qera (613)	54,113	
12-Mimbajtje dhe riparime (615)	4,855,054	6,201,818
13-Sigurime (616)	14,240,577	16,664,812
14-Kërkime dhe studime (617)	3,536,153	3,302,254
15-Të tjera (618)		
16-Personel jashtë njësive (621)	25,780,148	23,873,086
17-Komisione të ndërmjetme dhe honorare (622)	6,426,590	5,707,141
18-Shpenzime për koncesione , patent (623)		
19-Publicitet reklam (624)	367,741	524,929
20-Transferime udhëtim e dieta (625)	57,227,640	46,941,273
21-Shpenzime postare dhe telekomunikacioni (626)	48,607,412	
22-Shpenzime transporti (627)	3,171,722	3,135,894
23-Shërbime bankare (628)	24,274,732	29,151,792
24-Tatime dhe taksa vendore (632)	8,540,991	7,396,833
25-Tatime dhe taksa vendore (634)	16,926	13,574
26-Taksa e regjistrimit (635)	12,243,910	12,307,124
27-Tatime të tjera (638)		8,514
28-Shpenzime të tjera për personelin (648)	28,967	48,517
29-Vlera kontabel e AAM të shitura (652)(6722)		
30-Subvencione të dhëna (653) (sponsorizime)	385,688	10,115,761
31-Shpenzime pritje dhe përfaqësimi (654)	233,455	2,745,600
32-Gjoha dhe demshperblime (657)	1,817,530	594,053
33-Të tjera tatimore të panjohura (658)	981,276	1,653,544
34-Zbritje akorduar klient (666)	915,635	339,685
Shuma		
TOTALI	250,591,016	205,332,541
	250,591,016	205,332,541

Shënimet shoqëruese 4.1 deri në 4.17 janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare

MEGATEK Sh.a
 K816070500
 Superstrada Tiranë - Durrës, Km 6, Tiranë
 + 355 4 23 88 333
 www.megateksa.com

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
(Të gjitha balancat janë në lekë).

▪ Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Janë paraqitur si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur me 31.12.2017	Ushtrimi i mbyllur me 31.12.2016
Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)	2,777	3,015
Shpenzimet per interesat 661, 668(-)	(77,871,301)	(118,587,331)
Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)	70,802,497	
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 669(-)	(25,837,202)	(17,896,150)
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	3,148,784	136,200
Të ardhura të tjera		4,780,075
Shuma	(29,754,446)	(65,362,516)

▪ Shpenzime personeli

Numri mesatar i punonjësve dhe fondi i pagave janë si më poshtë :

Kategorite	Ushtrimi 2017		Ushtrimi 2016	
	Numer mesatar	Paga gjithsej	Numer mesatar	Paga gjithsej
Administrator, menaxher	10		10	
Specialist me arsim universitar	230		200	
Teknike				
Punëtor				
Shuma	240	76,455,471	210	61,397,351

4.14 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimin kontabël 2017 dhe 2016 janë si vijon:

	Llogaritja e Fitimit Tatimor	Ushtrimi i Mbyllur 31.12.2017	Ushtrimi i Mbyllur 31.12.2016
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT	102,298,533	(41,223,360)
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	4,406,941	5,474,836
1	Amortizime teje normave fiskale		
2	Shpenzime pritje e dhurime teje kufirit tatimor		
3	Gjoha, penalitete, demshperblime	981,276	1,786,075
4	Provizione qe nuk njihen		
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	914,635	3,688,761
6	Te tjera materiale jashte perdorimit (pa miratim)		
7	Te tjera shpenzime korrente	2,511,029	
III	PJESA E HUMBYES SE MBARTUR (-)	(35,748,524)	(42,981,397)
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMOR (I+II-III)	70,956,950	(78,729,921)
V	Shpenzimi i tatimit fitimit-15%	10,643,542	-
VI	FITIMI (HUMBJA) E USHTRIMIT	91,654,990	(41,223,360)

Shënime shoqëruese 4.1 deri në 4.17 janë pjesë e kësaj pasqyre financiare

MEGATEK Sh.a
K81607050Q
Superstrada Tiranë - Durrës, Km 6, Tiranë
+ 355 4 23 88 333
www.megateksa.com

MEGATEK sha
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
 (Të gjitha balancat janë në lekë).

Shoqëria ka qenë objekt i kontrollit tatimor për periudhën 2013; 2014 me objekt Tatimin mbi Fitimin. Organi Tatimor ka dalë me rezultatet e Raport Kontrollit Nr.6944/7 datë 23.09.2016 i cili ka rishikuar humbjen e vitit 2013 duke rivlerësuar shpenzimet e njohura nga subjekti e për pasojë e ka xjerrë me fitim fiskal. Në këto kushte nuk ka humbje të mbartur për vitet 2014; 2015 dhe 2016. Njoftim Vlerësimi i dalë nga Raport Kontrolli është dërguar në Gjykatën Administrative, dhe është objekt shqyrtimi nga Gjykata.

Për efekt kontabël humbja e vitit 2013 ka kompensuar fitimin e vitit 2014 dhe 2015. Viti 2016 ka dalë me humbje. Ndërsa viti 2017 ka dalë me fitim, i cili ka kompensuar humbjen e vitit 2016.

Tatim fitimi i ushtrimit është i llogaritur mbi fitimin e tatueshëm, i cili është rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar në tabelën e mësipërme. Sipas ligjit, shpenzime të pazbritëshme janë konsideruar edhe interesat bankare të ushtrimit në raste të tejkalimit të plotë të huasë krahasuar me katërfishin e kapitaleve të veta. Në këto pasqyra financiare nuk ka pasur tejkalim të këtyre normave. Si shpenzime të panjohura janë njohur gjokat dhe penalitetet nga aktiviteti tregtar si në shumën 981,276 lekë dhe 914,365 lekë shpenzime me dokumentacion jo të rregullt, si dhe të tjera shpenzime korrente për shumën 2,511,029 lekë.

4.15 Transaksione të palëve të lidhura

Vlerësimi është bërë duke marrë në konsideratë çdo transaksion dhe marrëdhënie të mundëshme, jo thjesht formën ligjore të tyre. Për vitin 2017 nuk ka transaksione me palë të lidhura.

4.16 Rentabiliteti Financiar

Nga analiza e gjëndjes dhe performancës financiare të shoqërisë, rezulton se në vitin ushtrimor 2017 fitimi mbi shitjet para shpenzimeve financiare rezulton pozitiv, fitimi neto mbi shitjet para tatim fitimit rezulton gjithashtu pozitiv. Shoqëria ka patuar një rritje të ndjeshme të xhiros vjetore në masën 21,2%, e cila është shumë më e lartë se rritja në vitin 2016. Kjo ka ardhur si pasojë e politikave tregtare dhe investimeve kapitale. Fitimi neto për vitin ushtrimor 2017 është 91,654,990 lekë. Ndërsa GROSS MARGIN është në masën 26,9 %, krahasuar me 25.9% të vitit 2016. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së gamës së produkteve, dhe uljes së normave valutore EUR dhe USD në raport me monedhën vendase. Ulja e koston së blerjes ka ndikuar në rritjen e marzhit të fitimit. Fakti që aktiviteti është i lidhur me mallrat e importit, ndryshimi i kursit të këmbimit të valutave të huaja reflektohet edhe në marzhin e realizuar të fitimit.

MEGATEK sh.a
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitet ushtrimor të mbyllur më 31.12.2017
(Të gjitha balancat janë në lekë).

Shoqëria ndodhet në kushtet e një manaxhimi rigoroz likuiditeti dhe nivele të pranueshme të solvabilitetit. Raporti i huamarrjes afatgjatë dhe asaj afatshkurtër në raport me kapitalin është në normën 1.96, duke mos ndryshuar shumë në krahasim me vitin 2016 (norma 2.28).

Kjo ka ardhur si pasojë e rezultatit me fitim i cili ka rritur kapitalin, si dhe pagesës së kësteve të huasë dhe fitimit nga kursi i këmbimit të fundit të vitit, duke qenë se kursi i këmbimit të EURO-s ka pësuar një rënie me 2.28 pikë më 31.12.2017 në krahasim me 31.12.2016.

Nisur nga vlerësimi i rrishtit, raporti i mësipërm është i pranueshëm për kredinë afatgjatë. Problem paraqet fakti se niveli i lartë i solvabilitetit, ndonëse shërben si garanci për huatë e marra dhe kreditorët, krijon vështirësi në performacën financiare të shoqërisë, në kushtet kur këto kapitale janë të ngurtësuara.

Shoqëria ka njohur rritje të shitjeve në sektorin familjar të shitjeve me pakicë, duke patur një raport të qëndrueshëm likuiditeti. Nisur nga fakti që në vitin 2017 janë kryer investime kapitale në lidhje me mallarat e sektorit të ndërtimit, pritshmëritë janë për një rritje të performancës së shitjeve me shumicë.

4.17 Ngjarjet pas datës së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Shifrat e vitit ushtrimor 2017 janë të krahasueshme me vitin ushtrimor 2016, për arsye se janë bazuar në (S.K.K), dhe nuk ka pasur ndryshime në politikat kontabile nga shoqëria. Pas datës 31.12.2017 nuk ka pasur ngjarje materiale të cilat mund të ndikojnë në vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë.

Shënimet shoqëruese 4.1 deri në 4.17 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare

